

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



## PUNIM DIPLOME

BESA NË TRADITË DHE FOLKLOR: RASTI KADARE (PRILLI I THYER DHE KUSH E  
SOLLI DORENTINËN)

MENTORJA:

Dr.RovenaVata

KANDIDATJA:

Faket Kuqi

Gjakovë, 2017

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: LETËRSI SHQIPE



**PUNIM DIPLOME**

BESA NË TRADITË DHE FOLKLOR: RASTI KADARE (PRILLI I THYER DHE KUSH E SOLLI DORENTINËN)

Komisioni:

Kryetar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

Anëtar \_\_\_\_\_

MENTORJA:

Dr.RovenaVata

KANDIDATJA:

Faket Kuqi

Gjakovë, 2017

## PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE</b> .....	<b>4</b>
1. Objekti dhe motivimi i temës .....	4
2. Metodologjia dhe metodat e punës.....	4
3. Baza teorike e punimit.....	5
4. Synimi i temës.....	5
<b>KREU I: Legjendë e letrarizuar-“Kush e solli Doruntinen”</b> .....	<b>7</b>
1.1. Legjenda e pasqyruar në formë letrare brenda një romani .....	7
2.2. Motivi folklorik dominues në roman .....	10
2.3. Elementët folklorike në romanin-baladë Kush e solli Doruntinën.....	15
<b>KREU II: Mishërimi i kanunit të letrarizuar në romanin “Prilli i thyer”</b> .....	<b>19</b>
2.1. Kulti i nderit shqiptar .....	19
2.2. Prilli i thyer-kanuni i maleve.....	20
2.3. Besa kanunore dhe tradita shqiptare në roman.....	25
<b>PËRFUNDIME</b> .....	<b>33</b>
<b>BIBLIOGRAFIA</b> .....	<b>36</b>

## **HYRJE**

### **1. Objekti dhe motivimi i temës**

Ismail Kadare dallohet për origjinalitet në shtjellimin dhe sjelljen e temave të spikatuara në botën letrare dhe kritikën e letërsisë shqipe. Proza e tij është një prozë sa origjinale dhe e mbushur me plot emocion. Ai shkruan dhe rrëfen në radhë të parë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Krijimtaria e tij është e lidhur me truallin shqiptar, me mitet, legjendat, doket, zakonet, vetëdijen dhe kulturën shqiptare. Objekt i kësaj teme diplome është evidentimi i temës së besës në traditë dhe në folklor, përmes analizës së dy romaneve të Ismail Kadaresë, romani *Kush e solli Doruntinen* dhe *Prilli i thyer*. Romani *Prilli i thyer* që në ngjizje të tij ka tharmin shqiptar, ka një dukuri tipike shqiptare siç është ajo e gjakmarrjes. Në roman jepet gjatë e gjerë mënyra sesi vepron kur merret një gjak, që në çdo rast një gjak duhet të merret patjetër, asnjë fis nuk duhet të shkojë gjakhupës. Objekti i punimit nënkupton shqyrtimin dhe analizimin e besës në tekstin letrar në dritën e teorive letrare që na japin mundësi për të realizuar këtë punim diplome.

### **2. Metodologjia dhe metodat e punës**

Duke qenë se Ismail Kadare me sjelljen e këtyre dy veprave të tij në botën dhe kritikën shqiptare, solli përplasjen e të kaluarës me të sotmen, një përballje të herë pas hershme me njëra-tjetrën nga njëra anë, por nga ana tjetër edhe një pjesë të traditave dhe kulturës shqiptare. Si metodë studimi për të realizuar këtë punim na nevojitet metoda biografike e autorit, pasi kemi një sërë faktorësh që kanë ndikur në formimin dhe zhvillimin e këtij personaliteti të letrave shqipe. Metodën sociologjike, e cila na ndihmon për të studiuar disa faktorë, që ndikojnë në botëkuptimin e një shkrimtari si: faktorët historike, kulturore dhe politike. Metoda e krahasimit për të nxjerrë të përbashkëtat dhe të veçantat nga secila vepër dhe për çdo kapitull apo çështje

studimore. Gërshetimi i këtyre metodave me njëra-tjetrën përbën atë që e quajmë metodologji kërkimi.

### **3. Baza teorike e punimit**

Për të realizuar këtë studim jemi bazuar fillimisht në literaturën bazë, pra në romanet e vetë autorit. Më pas na kanë ardhur në ndihmë edhe studime të shumta që janë bërë në lidhje me këto dy romane dhe me mënyrën e trajtimit të këtyre çështjeve. Së dyti kemi shfrytëzuar studimet e revistës Studime filologjike, artikuj dhe kritikë studimore, shtypi i kohës etj.

### **4. Synimi i temës**

Synimi i kësaj teme është nxjerrja në pah e të shkuarës mitologjike dhe historike të shqiptarëve te vepra *Kush e solli Doruntinën*, pasi Ismail Kadare gjen një nga burimet kryesore të frymëzimit për veprat e tij. Këtu kemi të bëjmë me një nga baladat shqiptare dhe ballkanike më magjepsëse dhe paradigmatiche, që sipas vetë shkrimtarit Kadare, pikërisht në mjedisin arbëresh ruan një nga variantet më të bukura, më origjinale dhe më të lashta, shprehje edhe e vendit qendror që zë koncepti i besës në identitetin dhe kujtesën kolektive të arbëreshëve të Italisë. Ritualit i moçëm i të vdekurit që ringjallet pësoi një përshtatje të pashmangshme gjatë kalimit nga paganizmi në krishterim. Në traditën folklorike shqiptare hasim shumë variante të tjera të baladës, e cila në rrjedhë të shekujve ka pësuar ndryshime të thella, që pasqyrojnë në njëfarë mënyre ndryshimet fetare dhe kulturore të vetë shoqërisë shqiptare. Prania e elementëve folklorike dhe kanunore në këtë roman ia shton magjinë dhe kërsërinë për studim më të detajuar.

Kurse në romanin tjetër të Ismail Kadaresë *Prilli i thyer*, i quajtur po nga vetë autori edhe si romani i Veriut, gjejmë të letrarizuar në formën më të plotë Kanunin e Lekë Dukagjinit. Miku, besa dhe gjakmarrja janë këto tre elemente që përbëjnë boshtin e terësisë së këtij romani. Ismail

Kadare e ka vendosur kuadrin e romanit të tij në krahinën e Mirëditës, një rrafshnaltë e izoluar nga pjesa tjetër e vendit, pa rrugë të denja për këtë emër, dhe bastion katolik tradicional. Romani fletë pas fletë pasqyron dhe i jep me detaje nenet më të dëgjuara dhe më të diskutuara që përbëjnë palcën e Kanunit të Lekë Dukagjinit. Gruaja e Besian Vorpsit, Diana bie në magjepsjen e gjakësit po ashtu sikurse Stresi e le veten të turbullohet nga Doruntina kur ajo është në agoni.

## KREU I: Legjendë e letrarizuar - “Kush e solli Doruntinen”

### 1.1 Legjenda e pasqyruar në formë letrare brenda një romani

Letërsia gojore shqiptare është e pasur dhe e frytshme, si e tillë ajo është shfrytëzuar shumë herë nga krijues të llojeve të ndryshme letrare, të cilët mbi të kanë ndërtuar krijimet e veta artistike. Një shfrytëzim të tillë ka bërë edhe shkrimtari Ismail Kadare, në novelen e tij *Kush e solli Doruntinën*. Këtu ai për substrat ka marrë baladën gojore të ngritjes nga varri për të mbajtur besën e dhënë, e cila njihet edhe si “balada e ringjalljes”, “balada e vëllait të vdekur”, apo edhe thjesht “balada e besës”.

Figura që vihet në qendër të kësaj novele, është ajo e Stresit, një figurë e realizuar që mishëron thelbin shoqëror të një feudali patriotik dhe njëkohësisht është dhënë me nuanca psikologjike dhe individuale. Autori e pajis këtë figurë me tiparet e ndershmërisë, ndjenjës së detyrës, logjikës së qartë që nuk errësohet nga bestytnitë dhe nuk përjashton ndjenjat e holla, siç është simpatia e tij për Doruntinën. Kjo figurë jepet në evolucion<sup>1</sup>, ja si na shfaqet në roman:

*Edhe këtu mund të ketë pasur lëkundje: t’ia tregoj të shoqit të vërtetën, apo jo? Ka mundësi që më tepër për arsye njerëzore, për të mos e plagosur në sedër, sesa për ndonjë shkak tjetër, i shkruan se po ikën me të vëllanë, Konstandinin. Aq më tepër që kjo ishte dhe e besueshme, për shkak të besës që ky i kishte dhënë, besë që dihej tashmë nga të gjithë, duke përfshirë edhe të shoqin<sup>2</sup>.*

Pra këtu vërehet logjika e qartë e Stresit, i cili çdo gjë e mendon me imtësi madje edhe atë, që Doruntina mund t’i këtë shkruar burrit të saj para se ajo të nisej me të dashurin e saj dhe sipas tij ajo e gënjeu, që kishte ardhur vëllai për ta marrë dhe që po largohej me të.

Në fillim autori pasqyron iluzionin e personazhit të vet për mundësinë për të qenë një zbulues i paanshëm i së vërtetës në rrethanat e një shoqërie të ndarë në klasa dhe ku për më tepër mbizotëron ndeshja e këtij iluzioni me realitetin shoqëror.

Autori ka synuar të pohojë tiparet e larta të karakterit të shqiptarit që janë pjesë përbërëse e vitalitetit të popullit tonë. Këto tipare do t’i pohojë përmes figurës së Kostandinit, i cili në novelë

<sup>1</sup> Klara Kodra, në revistën “Nëntori”, nr.2, Tiranë, 1980.

<sup>2</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, Onufri, Tiranë, 2004, f. 109.

jepet përmes retrospektivës, ndonëse jepet si i vdekur para fillimit të ngjarjeve, përmes figurave të shokëve të tij dhe mandej figurës së Stresit, kur ai pranon idealet e tyre dhe pranimit i këtyre mendimeve shihet si një kthesë, një fitore morale në jetën e personazhit, t'i flasë hapur popullit dhe të japë dorëheqjen. Dhe në finale e novelës tingëllon në mënyrë të fuqishme, përmes fjalëve të Stresit, ideja e qëndresës, ideja e pohimit të vetive të larta morale të popullit shqiptar<sup>3</sup>.

*Ishte ende e rrallë. Sapo kishte mugulluar, ndaj ishte trillane, si një lule e egër, që kishte nevojë për selitje. Dhe për të lehtësuar shpjegimin, ata i kujtuan Stresit një ngjarje, që kishte ndodhur vite më parë, kur Kostandini kishte qenë gjallë, në një katund jo shumë larg prej andej, ku një njeri kishte vrarë mikun e ftuar në shtëpi. Stresi e dinte. Atje që përdorur fjala “**e preu në besë**”. Gjithë katundi, të vegjël e të mëdhenj, kishin pësuar një tronditje të rëndë. Dhe vendosën bashkërisht që kurrë të mos ndodhte një kob i tillë. Madje, shkuan më larg: vendosën që kushdo që kalonte në katundin e tyre, i njohur a i panjohur, ishte “**në besë**”, pra ishte i shpallur e i mbrojtur si mik. I hapej dera në çdo orë të ditës e të natës, i jepej të hante e të pinte dhe ishte i paprekshëm<sup>4</sup>.*

Shokët e Kostandinit i kujtojnë Stresit një ngjarje që kishte ndodhur kohë më parë kur Kostandini ishte gjallë, ku një njeri kishte vrarë mikun në shtëpinë e tij, pra ai e kishte prerë atë në besë dhe pastaj vendimin e gjithë fshatit se si duhet të pritej miku në katundin e tyre, duke treguar kështu që besa dhe miku janë të shenjtë për shqiptarët.

Evonimi i legjendës së ringjalljes ka qenë mërgimi i parë i Kadaresë. Ky ishte një mërgim i veçantë, me një përmasë, vetëm në kohë, privilegj që e fitojnë, bashkë me mbikohësinë, vetëm talentet e fuqishme<sup>5</sup>.

*Kështu fliste Kostandini në ato pasditet e tyre të paharrueshme te Bujtina e Re, ku s' rreshtin së foluri punë Arbërie. Kuvendonin ose, me saktë, arbëronin, siç thoshin disa, herë mendueshëm e herë me afsh. Ja , unë do t'ia jap **besën** nënës, se do t'ia sjell Doruntinën nga shtëpia e burrit në çdo kohë që të dojë ajo dhe, sido që të ndodh, edhe i shtrirë po të jem nga sëmundja, edhe me gjysmë shpirt, edhe me një këmbë apo pa sy, madje edhe...unë nuk e shkel **besën**.*

<sup>3</sup> Klara Kodra, në revistën “Nëntori”, nr.2, Tiranë, 1980.

<sup>4</sup> Ismail Kadare, *Kush e sollti Doruntinën*, f. 167-168.

<sup>5</sup> Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, Tiranë, 2009, f. 61.



Pastaj rrëfëhet ajo qka Kostandini u thoshte shokëve të vet lidhur me martesën e motrës së tij, për besën që ai ja jep nënës që gjallë a vdekur ai do ia sillte vajzën, duke treguar këtu që besa ishte një nga vlerat më të rëndësishme për të.

Doruntina kishte nevojë për mbrojtje, kurse shqiptarët e kohëve moderne, për mesazhin humanist të legjendës së njohur me emrin e saj. Një mijë e ca vjet pas ringjalljes së Krishtit arti i arbërve shpallte një ringjallje tjetër, rilindjen e njeriut për të shlyer pengun e kësaj jete. Mesazhi i Kostandinit është thirrja për një rilindje morale. Nuk dihet se kur ka qenë ajo më e nevojshme, në kohën e krijimit të baladës së popullit apo të veprës së shkrimtarit<sup>6</sup>.

*-Ishte i rëndë, natyrisht, i padurueshëm dështimi i Kostandinit, shkelja e besës, apo jo ?-pyeti STRESI.*

*-Po, natyrisht, ishte i rëndë... Sidomos pas mallkimit të nënës... Veçse ky nuk ishte një dështim, zoti Stres... Ai arriti ta mbante besën... Pak me vonësë, sigurisht... vonësë e shkaktuar prej një arsyeje madhore... vdekjes... megjithatë, ai e mbajti...<sup>7</sup>.*

Shokët e Kostandinit pasi i folën shumë Stresit për Kostandinin dhe i treguan aq shumë gjera për të, për besimin e tij, për sendet që ai i konsideronte më vlerë, në fund për ta përmbyllur tërë këtë enigmë konstatuan që ai mbajti besën dhe e solli Doruntinen.

Në romanin *Kush e solli Doruntinen* çështja qendrore që rrihet nga të katër anët është të gjendet një njeri që e solli Doruntinen. Sipas baladës popullore është Kostandini që ngrihet nga varri dhe shkon e sjell motrën, për ta çuar në vendin e premtuar që i patë dhënë kur ishte gjallë nënës së tij<sup>8</sup>.

Duke u nisur nga legjenda e Kostandinit me Doruntinen, njëra nga më të lashtat e epikës sonë legjendare, që në motërzimet e veta haset dhe në popuj të tjerë, legjendë që është ngritur mbi motivin e besës, autori zberthen një varg idesh e situatash mbi motivin e besës, autori zberthen një varg idesh e situatash që flasin për kohën, për problemet shoqërore, ekonomike e patriotike, duke i parë e interpretuar ato me frymën tonë të shkrimtarit të realizimit socialist, nga pozitë

<sup>6</sup> Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, Tiranë, 2009, f. 62.

<sup>7</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 184.

<sup>8</sup> Tefik Çausi, *Dashuria dhe Besa (ese për romanin e Kadaresë "Kush e solli Doruntinen")*, Albas, Tiranë, 2004, f. 29.

tona marerialiste. Në përshtatje me materialin brendësor dhe thurjen artistike që ofron vetë legjenda tek kjo baladë, autori ka gjetur formën e novelës<sup>9</sup>.

Ideja e qëndresës që identifikohet me poetizimin e besës zbulohet në plan moral dhe jo në rrënjët e saj historiko-shoqërore. Kjo ia dobëson disi novelës vlerën aktuale.

Nga ana tjetër vendi tepër i madh që i jepet në novelë së ashtuquajturës enigmë të ardhjes së Doruntinës sikur është në vetvete jo aq funksional dhe ngjan sa ka për qëllim të mbajë gjallë interesin e lexuesit nëpërmjet kureshtjes, më tepër sesa t'i shërbejë idesë, duke e qartësuar atë<sup>10</sup>.

## 2.2 Motivi folklorik dominues në roman

Besime shqiptare, besime ndërballkanike dhe madje edhe botërore kanë motive të tilla për ngritjen e të vdekurit nga varri në formën e lugatit, hijes, fantazmes ose të shpirtit të paqetë<sup>11</sup>.

Balada e Kostandinit dhe Doruntines na kumton pushtetin e madhërisëm që nga besa, e cila ka aftësinë të ngrejë edhe të vdekurin nga varri.

Në thelb të motivit folklorik është dhënia e fjalës dhe mbajtja e saj edhe pas vdekjes, kjo e pasqyruar në shumë poezi, tregime apo romane shqiptare kryesisht. Besa, në traditë dhe në folklor ka qenë dhe është një virtyt i shqiptarëve për periudha shekullore. Besa, thotë Ismail Kadare në kuptimin e saj të mirëfilltë ka qenë një nga cilësitë madhore, titanike dhe disa herë tragjike të shqiptarit<sup>12</sup>.

Shprehja “*Shqiptari, kur jep fjalën, vret djalën*” nuk është frazeologji, por një realitet, që është vërtetuar shpesh dhe, disa herë, në mënyrë të dhimbshme në jetën tonë të kaluar<sup>13</sup>. “*Edhe lisit, po ia le fjalën e s’e mbajti, i thahen degët*”, thotë populli. *I lagësht me ujë e me baltë është vazhdimisht varri i Kostandinit, ngaqë ai nuk e mban besën. Kur nëna, e mbetur qyqe, shkon në varreza ditën e të vdekurve dhe e mallkon të birin me fjalët:*

---

<sup>9</sup> Dilaver Dilaveri, në gazeten: “Zëri i Rinisë, 09.08.1980.

<sup>10</sup> Klara Kodra, në revistën “Nëntori”, nr.2, Tiranë, 1980.

<sup>11</sup> Rovena Vata, *Urë fjalësh midis letërsisë dhe antropologjisë*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2015, f. 237.

<sup>12</sup> Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Onufri, Tiranë, 2002, f. 26.

<sup>13</sup> Rovena Vata, *Urë fjalësh midis letërsisë dhe antropologjisë*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2015, f. 239.

*“Kostandin, të ardhhtë gjëma,*

*Ku e ke besën që më dhe?*

*Besa jote nënë dhe...”*

Kjo është vërtet gjëma më e madhe për një shqiptar. Është një gjëmë e tillë përpara së cilës sprapsen edhe kufijtë e vdekjes. Nga një mallkim i tillë s’ të mbron dot as dheu dhe as varri. Thirrja e nënës dhe asgjë tjetër e bën Kostandinin të bëjë të pamundurën, të thyejë ligjet e jetës e të vdekjes, të ngrihet nga varri dhe të vrapojë natën nën hënë nëpër rrugën e pluhurosur për t’i sjellë nënës motrën e martuar larg, ashtu siç i kishte dhënë fjalën dikur<sup>14</sup>.

Për besën kanë folur jo vetëm studiues e letrarë, por edhe sociologë duke e quajtur atë “kontratë” të pashkruar. Në folklorin shqiptar ka një numër shumë të madh këngësh, fjalësh të urta që çmojnë aspekte të ndryshme të besës dhe rolit të saj. Ja disa prej tyre: “*Detit i ka hije vala, burrit i ka hije fjala*”, “*E humbe besën humbe gjithçka*”, “*Muri luan, besa s’ luan*”, “*Ku është besa aty është edhe shpresa*”<sup>15</sup>. Apo formulime të tilla si “*shkelja e besës*”, “*marrja e mikut në besë*”<sup>16</sup>, “*dhënia e besës njëzetëkatër-orëshe gjaksi*”, “*dhënia e besës tridhjetëditëshe*”, “*besa e lidhur midis njerëz-ve*”, “*besa midis katundeve*”, “*midis flamureve*”<sup>17</sup>.

Doruntina, e ringjallur prej tij mjeshtërisht nga arkivat, do t’u vinte në ndihmë përsëri njerëzve shqiptarë; ashtu sic pat gjendur asaj dikur i vëllai, Kostandini. Balada e saj ishte strehë për kohë të vështira, ushqim për të mundur mospasjen, për të frymëzuar dinjitetin njerëzor, kur ai rrezikohet nga përtharja<sup>18</sup>.

Legjenda e Fjalës së Dhënë (Kostandini dhe Doruntina) është një nga margaritarët më të çmuar në thesarin e krijimtarisë folklorike të popullit tonë, margaritar që ka emërtuar reflektime intensive, shumëngjyrëshe edhe në folklorin e shumë popujve të tjerë. Duke u paraqitur në

---

<sup>14</sup>Po aty, f.27.

<sup>15</sup>Zyhdi Dervishi, *Vështrime të kryqëzuara në det*, Sociologjia Kulturore1, “Jerusa-lem”, Tiranë, 2003.

<sup>16</sup>Ismail Kadare, *Eskili ky humbës i madh*, Onufri, Tiranë, 2001, f. 113.

<sup>17</sup>Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Onufri, 2002, f. 26.

<sup>18</sup>Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë, Naimi*, Tiranë, Tiranë, 2009, f. 64.

motërzime të ndryshme edhe në krijimtarinë folklorike të shumë popujve të tjerë, shpesh është debatuar dhe ende diskutohet intensivisht ndër studiuesit për autorësinë e kësaj legjende<sup>19</sup>.

*-Ju keni të drejtë, zoti shef, përderisa flisni për botën e sotme, të zakonshmen, por s' duhet të harroni se ai, ne të gjithë, në fjalët dhe mendimet tona kishim parasysht një botë tjetër, me një përmasë të re, më kuptoni, një botë me besë. Në këtë botë gjithçka mund të ndodhte ndryshe*<sup>20</sup>.

Kostandini ashtu si edhe shokët e tij ishin kundër ligjeve, institucioneve, policisë, burgjeve etj, ai thoshte, që këto duhen të zëvendësohen me ligje të brendshme, ku njeriu të dënonte vetë njeriun dhe jo të dënohen nga institucionet, pasi në botën e tyre mbizoëronte besa dhe kjo botë u interesonte atyre, pasi ishte më e rëndësishmja.

Vlen të përmendet se edhe studiuesit e vizitorët e huaj janë mrekulluar ose, së paku, habitur nga besa, ose besnikëria e shqiptarëve në mbajtjen e fjalës së dhënë. Këtu misionari i Foreign Office në vendet ballkanike Edmund Spenceri, i cili ka vizituar edhe Shqipërinë në mesin e shekullit të kaluar shkruante se: *“Shqiptarët kur e japin fjalën nuk e thyenjë atë”*. Ndërsa Edith Durhami ka nënvizuar se: *“Shqiptarët i mbahen fjalës së dhënë me ndershmëri krejt të panjollësor, se besa justifikon e bën të mundur të pazakonshmen, se shqiptarët me instinktin e një fisniku krenohen me besnikëri të palëkundur ndaj miqve dhe të njohurve”*.

Një nga njohësit e drejtpërdrejtë të kulturës tradicionale të shqiptarëve gjatë gjysmës së parë të dhjetëvjeçarit të dytë të shekullit tonë, diplomati e dietari amerikan Xhorxh Fred Williams ka shkruar:

*“BESA” është tradita më e shenjtë; kur njeri ka besën e një personi të mirë të njerit fis, çnderimi më i madh e prët fyesin e saj prej çdo personi të atij fisi. Besa e shqiptarit jo vetëm që mbahet dhe mbrohet me vullnetin më të mirë, por shqiptari po të jetë nevoja jep edhe jetën për të mbajtur besën. Një udhëtar nën fjalën e besës është nën mbrojtje të shenjtë”*<sup>21</sup>.

Në thelbin e vet romani “Kush e solli Doruntinën” zhvillohet në të njëjtën frymë me përmbajtjen e baladës “Kostandini dhe Doruntina”, e njohur si balada e ringjalljes, apo e ngritjes së të vdekurit nga varri për të mbajtur besën, fjalën e dhënë. Shkrimtari e ka njohur këtë baladë në

<sup>19</sup> Rovena Vata, *Urë fjalësh midis letërsisë dhe antropologjisë*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2015, f. 239.

<sup>20</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, f. 169.

<sup>21</sup> Zyhdi Dervishi, *Vështrime të kryqëzuara në det*, Sociologjia Kulturore 1, Jerusalem, Tiranë, 2003, f. 34-38.

gjithë larminë e ruajtjes së saj, në jug e veri, me të gjitha ngjyrimet që ajo përmban nga një variant në tjetri, me të gjitha ato imtësi shpesh herë të pashpjegueshme që kanë ruajtur deri në kohët e sotme këto variante dhe që kërkojnë vëmendje më shumë se një formulë kalimtare rastësore, sepse pikërisht pas tyre gjendet zona e kryehershme e tabusë<sup>22</sup>.

Që të bëhej më e imponueshme në vetëdijen e malësorëve, besa sidomos për çështje të rëndësishme, “*lidhej*” në vende të konsideruara të shenjta si: *kisha, xhamia, teqe, tyrbe, vende të mira*. Në situatë lufte, kur koha nuk priste për të shkuar në vende të shenjta, besa “*lidhej*” edhe mbi varret ose kufomat e të rënëve në luftë<sup>23</sup>.

Në baladat kryesisht ka konflikte, në baladën me motiv të vëllait të vdekur ose të besës së dhënë, konflikti fillon nga paraqitja e veprimit. Konflikti i jashtëm në këtë rast e ka pikënisjen të martesë e motrës në një vend të largët. Konflikti si fat tragjik do të përqendrohet mbi tri figurat kryesore të syzhetit të baladës: nënës, motrës, vëllait, si pjesëtare e fatit tragjik, nëna do ta përjetojë atë në mënyrë të dyfishtë, qoftë si dhimbje të madhe për vdekjen e parakohshme të djemve, qoftë edhe si dhembje e mall për të bijën që është martuar në vend të largët<sup>24</sup>.

Momenti i dhënies së besës është edhe themeli i kësaj balade, nëna i thotë Kostandinit:

*“Kostandin, o biri im,  
Ç’ është kjo puna jote,  
Që do t’ma çojsh vajzën kaq’ larg?  
Se n’e daça unë për gëzim,  
Për gëzim pastaj s’e kam.  
Në e daça unë për helm,  
Unë për helm atë s’e kam,  
“vete unë mëm’e ta sjell”<sup>25</sup>.*

Ndërsa Mitrush Kuteli te “*Tregime të moçme shqiptare*” duke kaluar nga poezia në prozë këtë baladë e quan “*Besa e Kostandinit*”, momentin e dhënies së besës e përshkruan kështu:

<sup>22</sup> Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, Tiranë, 2009, f.102.

<sup>23</sup> Po aty, f.39.

<sup>24</sup> Sabri Feti, *Çështje të folklorit 5*, Tiranë, 1997, f. 104 - 105.

<sup>25</sup> Këngë popullore legjendare, Instituti i shkencave, Tiranë, 1955, f. 23.

*“Kostandin, biri im, ë’ po më thua ti kështu? Ia kthente e ëma. - Aqë larg do ti që të ma shpiesh Doruntinën time? Se në daça për gëzim, për gëzim nuk do ta kem; se në daça për helm, për helm nuk do ta kem. - Të jap besën, zonja mëmë, se kur ta duash ti Doruntinën, qoftë për gaz, qoftë për helm, vete unë e ta sjell!”<sup>26</sup>.*

Kadareja ekspozoi një nënshtrat krejt të mospëfilluar të kulturës kombëtare. Legjenda e Doruntinës nuk ishte “punë legjendash”, por konkluzion i një epoke historike. Ajo shpallte lidhjet e lashta të kulturës së popullit tonë me ato të vendeve të qytetëruara të kontinentit<sup>27</sup>.

*Ju keni dëgjuar për mallkimin që Zonja Mëmë i bëri të birit për shkeljen e besës dhe e dini pastaj se si tri javë pas këtij mallkimi Doruntina erdhi, më në fund, në shtëpi. Ja përse unë e shpall dhe e rishpall se Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veçse vëllai i saj Kostandini, fjala e dhënë e tij, besa e tij. Asnjë shpjegim tjetër s’ka dhe s’mund të ketë ky udhëtim. S’ka rëndësi, u ngrit apo s’u ngrit i vdekuri nga varri, për ta kryer vetë atë që duhej të kryente, s’ka rëndësi cili që kalorësi dhe ç’kalë shaloi ai atë natë të errët kur u nis, ç’krah mbanin frerin dhe mbi flokët e kujt binte pluhuri i udhës. Secili nga ne ka pjesën e vet në këtë rrugëtim, sepse besa e Kostandinit, ajo që e solli Doruntinën, ka mbirë këtu, midis nesh”<sup>28</sup>.*

Këtu paraqitet fjalimi i Stresit lidhur me misterin e ardhjes së Doruntines dhe sqarimi i tij se kush e solli Doruntinën, duke treguar për mallkimin e nënës dhe menjëherë pas këtij mallkimi ardhjen e saj, më këtë rast ai shpall që ishte vet Kostandini, që e solli të motrën, ishte besa e tij. Me këtë rast Stresi detyrohet të pranojë, që Doruntina ka udhëtuar me të vëllain e vdekur dhe këtë e zbulon pas shumë bisedash me shokët e Kostadinit, përmes tyre ai njihet me thellësisht me botën e Kostandinit dhe se sa e rëndësishme ishte mbajtja e besës për të.

Baladat popullore i quajmë monumente të kulturës shpirtërore, sepse në to është projektuar dhe realizuar artistikisht ekzistenca shpirtërore dhe etike e formimit të kuptimeve të gjera etnike të popujve, që nga paraetnitë mesdhetare deri te etnitë e mëvonshme të popujve, që nga paraetnitë

---

<sup>26</sup> Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, Mitrush Kuteli, Tiranë, 2005, f. 42.

<sup>27</sup> Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, Tiranë, 2009, f.111.

<sup>28</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, f. 184.

mesdhetare deri te etnitë e mëvonshme të popujve të Ballkanit, që i ka ruajtur gjurmët e veta edhe në kultura kombëtare të këtyre deri më sot<sup>29</sup>.

Këtu marr shkas të përcjell mesazhin e Kadaresë te romani “*Kush e solli Doruntinën*” i cili thotë: *se Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veçse vëllai i tij, Kostandini, fjala e dhënë e tij, besa e tij. Asnjë shpjegim tjetër s’ka dhe s’mund të ketë ky udhëtim.*

### 2.3 Elementët folklorike në romanin-baladë *Kush e solli Doruntinën*

Si krijim gojor balada është shumë e moçme dhe në të shprehet shpirti i popullit me ndjesitë e mendësitë e tij. Duke hulumtuar baladën dhe duke i shpaluar elementet e strukturës së saj, shohim se ajo përmban të gjitha ata përbërës që i duhen një veprë letrare: ka hyrjen, kompozicionin, thurjen, shturjen dhe si e tillë magjeps me nivelin e ndërtimit të saj<sup>30</sup>.

Përpunimin e lëndës folklorike autori e ka bërë si në poezi, ashtu edhe në prozë, por në këtë të fundit atë e hasim më shpesh e më mjeshtërisht. Në prozë gjejmë jo momente, kapituj apo fragmente, por vepra të plota që janë bazuar mbi folklorin<sup>31</sup>.

Novela *Kush e solli Doruntinën* është ndërtuar mbi shtratin popullor të baladës së vëllait të vdekur. Kjo baladë kultivohet ndër shqiptarë shumë moti dhe si e tillë njihet në disa variante, pasi është krijuar në të gjitha viset ku banojnë shqiptarët<sup>32</sup>.

*Nëna e pyet: kush të solli, moj vajzë? Ajo i përgjigjet: vëllai, Kostandini. –Ah, ashtu thotë, Kostandini? O Zot i madh, po Kostandini ka tre vjet që ka vdekur, bashkë me krejt vëllezërit*<sup>33</sup>.

Përveç argumenteve që kanë shprehur shumë studiues për baladën e ringjalljes dhe autorësinë e saj, duke e emërtuar se rrënjët i ka në Shqipëri, shpreh edhe unë mendimin tim personal duke e studiuar këtë baladë me sy kritik, po jap disa shembuj:

<sup>29</sup> Sadri Feti, *Aspektete të studimit të baladës popullore shqiptare*, në: “Gjurmime albanologjike”, Folklor dhe etnologji, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2014, f. 41.

<sup>30</sup> Arbnora Dushi, *Elemente të epikës gojore në prozën e Ismail Kadaresë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 20.

<sup>31</sup> Tefik Çausi, *Universi i Kadaresë*, 2001.

<sup>32</sup> Arbnora Dushi, *Elemente të epikës gojore në prozën e Ismail Kadaresë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004, f. 21.

<sup>33</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinën*, f.21.

1. “Mblesërija”, shkelsi tek Doruntina kemi një dallëndyshe-element tipik folklorik.
2. “Dhënia” e besës nënës nga Kostandini, elementi tradicional i rëndësishëm i Shqiptarëve si edhe element folklorik.

*Konstandin, të ardh të gjëma,*

*Ku e ke besën që më dhe,*

*Besa jote nën dhe*<sup>34</sup>.

Janë vargje me shumë kuptim, të ndjeshme dhe mjaft të rënda, duke pasur parasysh që thuhet nga një nënë për të birin e saj. Përmes tyre mund të vërehet mallkimi i nënës së Kostandinit tek varri i tij, duke e quajtur atë si besëshkelës.

*Pasi doli nga shtëpia, ajo pa përjashta të posaardhurin hipur mbi kalë, i cili iu duk si Kostandini, megjithëse mezi njihej, ngaqë ishte krejt i pluhurosur prej rrugëtimit. Por, kur shtegtari që nga maja e kalit i tha se ishte Kostandini, që kishte ardhur për ta marrë e për ta çuar tek e ëma, sipas premtimit që kishte bërë përpara dasmës së saj, asaj i iku çdo dyshim. (Këtu duhen kujtuar zhurma e madhe që u bë në atë kohë për fejesën e Doruntinës në një vend aq të largët, kundërshtimi i vëllezërve të tjerë e sidomos i nënës, që nuk donte ta jepte vajzën aq larg, këmbëngulja e Kostandinit që kjo fejesë të bëhej dhe, më në fund, premtimi dhe besa e tij se do të ishte ai që do t’ia sillte nënës të bijën, sa herë që ajo kishte nevojë për të)*<sup>35</sup>.

Këtu kemi të paraqitur Doruntinen në momentet që Kostandini shkon për ta marrë e për ta dërguar tek e ëma sipas premtimit të bërë asaj që do t’ia sillte vajzen sa herë që ajo donte ta shihte. Përshkruhet Kostandini dhe gjendja e tij, dyshimi i Doruntinës se a është apo nuk është vëllai i saj pastaj kundërshtimi i vëllezërve dhe këmbëngulja e tij për ta martuar të motrën aq larg.

3. “Zakoni” dhe tradita e Shqiptarëve që vajza e martuar, bija, motra të jetë e pranishme në gëzimet dhe hidhërimet familjare.

---

<sup>34</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 69.

<sup>35</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 33.



-E kam të zorshme t'i them ashtu siç ishin fjalët e saj, sepse u trondita jashtë mase, por kuptimi, pak a shumë, ishte ky: Konstandin, ku e ke fjalën që më dhe se do të ma sjellësh Doruntinen sa herë të kem nevojë për të? Sepse, siç mund ta dini, zoti Stres, atë që e di gjithë bota, Kostandini i kishe dhënë **besën** s'emës se...

-E di, e di,- tha Stresi, vazhdo tutje<sup>36</sup>.

Rojtari i varrezave i tregon Stresit për atë që kishte parë e dëgjuar para 3 jave tek varret e vëllëzerve Vranaj ku nëna e tyre tek secili nga ata kishte ndezur nga një qiri, ndërsa tek varri i Kostandinit dy dhe kishte filluar ta mallkonte atë. Njëherazi ai shfaqet i befasuar se si një nënë është në gjendje ta mallkonte apo ta nemte të birin e saj të vdekur në atë mënyrë.

Këtë rrëfim të rojtarit të varrezave, mund ta quajmë edhe si orientim për Stresin drejt zbulimit të së vërtetës.

##### 5. "Përdorimi i numrave 3 dhe 9" veçori e folklorit tonë.

*Që s'erdhi as në zinë e tmerrshme të **nëntë** vëllëzerve, kjo do të thotë se nuk e dinte mynxyrën,- tha ndihmësi<sup>37</sup>.*

Ose,

*Duke ecur drejt portës për ta hapur, krejt e hutuar nga e papritura, pa e besur aspak se po dëgjon zërin e vajzës së vet, plaka, si për të hequr dyshimin, pyet: "Po kush të solli?. Sepse ka **tre vjet** që ajo e pret vajzën t'i vijë për t'iu gjendur pranë në fatkeqësi dhe vajza s'vjen e s'vjen. Që jashtë Doruntina i përgjigjet: "Më solli im vëlla, Kostandini"<sup>38</sup>.*

Ose,

*Stresit iu kujtua varrimi i **nëntë** vëllëzerve Vranaj, **tre vjet** më parë. Fatkeqësi kishin ndodhur përherë, njëra më e rëndë se tjetra dhe, nganjëherë të tilla, saqë dukej se prej kujtimit të tyre*

<sup>36</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 59.

<sup>37</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 23.

<sup>38</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 25.

*mund të të shpëtonte vetëm çmenduria, por një gjëmë të tillë, nëntë arkivole djemsh nga një shtëpi, brenda një jave, s'mbahej mend në asnjë brez njerëzor*<sup>39</sup>.

6. “Mbajtja zi” (veshja me të zeza nga të afërmit kur ata vdesin, për një vit, për disa ose për tërë jetën). Gjithë këto fakte të çojnë të mendosh dhe të thuash se motivi i ringjalljes së Kostandinit është me autorsi shqiptare, duke i qëndruar pro edhe vetë këtij mendimi.

*Zonja plakë ankohej shpesh që vajza u martua në skaj të botës dhe që në ditë të zezë nuk iu gjet pranë*<sup>40</sup>.

Kostandimi kishte për të përmbushur një mision të caktuar: misionin e besës së papërmbushur.

Personazhi folklorik ngrihet nga varri në të gdhirë të ditës, si në rastin:

*“Si u ngryse e u mbyll kisha,  
Ja tek drita e qirijvet,  
Kostandini u ngrit nga varri”*<sup>41</sup>.

---

<sup>39</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 26.

<sup>40</sup> Ismail Kadare, *Kush e solli Doruntinen*, f. 23.

<sup>41</sup> Këngë popullore legjendare, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1955, f.25.

## KREU II: Mishërimi i kanunit të letrarizuar në romanin “Prilli i thyer”

### 2.1 Kulti i nderit shqiptar

Ismail Kadare protagonist i jetës kulturore dhe letrare në Shqipëri për më se gjysmë shekulli krijoi një vepër të madhe dhe të papërsëritshme, dhe i dha një përmasë të re letërsisë shqipe duke e imponuar atë si fakt dhe si faktor edhe të procesit letrar botëror.

Personaliteti dhe vepra e Kadaresë kanë luajtur rolin e një shkolle në zhvillimin dhe ripërtëritjen e letërsisë shqipe; vepra e tij ka ushtruar një ndikim aq të madh dhe kanë pasur një forcë aq të madhe tërheqëse saqë, pa to, nuk mund të kuptohet gjithë procesi i risimit dhe i emancipimit të kulturës shqiptare në rrjedhë të kohëve moderne të saj.

Romani “*Prilli i thyer*” është cilësuar si romani i “kultit shqiptar të nderit”, një prej atyre albanizmave që shumë dijetarëve të huaj u ka mjaftuar për të përveçuar botën tradicionale shqiptare, pothuajse në të gjitha gjuhët e huaja titulli i romanit “Prilli i thyer” nuk e ruan kuptimin e idiomës së ligjëritit etnozakonor burimor: prilli i thyer, 17 prill, dita e fundme e “jetës në besë” të Gjorgut, dita e fundme e mbrapsht-numërimit të jetës së tij: prilli në të sosur, prilli në të mbaruar, prilli i tashmë i thyer; ashtu siç do të ishin përkthyer dhe idiomat e tjera me kuptim të mbyllur të shqipes, që formojnë një gjedhe të vetme: ditë e thyer, javë e thyer, stinë e thyer, dimër i thyer, hënë e thyer, mot i thyer, moshë e thyer. Prill përtej gjysmës<sup>42</sup>.

Në një farë mënyre ky roman shkoi në pajtim me kultin e traditës. Eposi dhe kanuni janë dy nga tri përmendoret më të mëdha të trashëgimisë së popullit shqiptar, dhe të dyja këto vepra, njëra e vlerësuar në heshtje dhe tjetra e papenguar po në heshtje, u përgjigjen pikërisht këtyre dy përmendoreve. Një situatë të tillë e gjejmë të mishëruar edhe te romani që kemi në shqyrtim:

*Rrafshi është i vetmi truall në Evropë, që, duke qenë pjesë e një shteti modern, e përsëris, pjesë e një shteti modern europian dhe jo një vendbanim tribush primitive, i ka flakur ligjet, ngrehinat juridike, policinë, gjyqet, me një fjalë, krejt makinën shtetërore, e ka flakur, më kupton, i ka pasur dikur dhe i ka hedhur për t'i zëvendësuar me ligje të tjera, morale, të cilat janë kaq të plota, saqë i kanë detyruar zyrtarët e huaj të pushtimit dhe, më vonë, administratën e vetë shtetit*

---

<sup>42</sup> Shaban Sinani, “*Kanuni total*” te *Prilli i thyer*, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009, f. 119.

*të pavarur shqiptar, t'i njohin ato dhe ta lënë kështu Rrafshin, domethënë gati gjysmën e mbretërisë, jashtë mbikëqyrjes së shtetit*<sup>43</sup>.

## **2.2 Prilli i thyer-kanuni i maleve**

“Kanuni i Lekë Dukagjinit” ose “Kanuni i Maleve”, quhet i tillë pasi fushën e tij të rritjes, veprimit dhe zbatimit e kishte në malet e Veriut. Malet e kanë pasur të lidhur fort jetën e tyre me “Kanunin e Maleve”. Malet mbanin çdo peshë të normave dhe neneve të veprimit të tij.

“Kanuni i maleve” në traditën etnojuridike; zë një vend të rëndësishëm si ruajtës i ligjeve zakonore<sup>44</sup>. Kanuni ishte ndërgjegjja e njeriut në botën e maleve<sup>45</sup>.

Në kohën që Kadare e shkroi romanin *Prilli i thyer*, kanuni ishte shkurorëzuar nga fuqia etnozakonore dhe ishte thjesht një traditë. Nuk ishte një realitet parësor, si në vitet 1930, por një përmendore kulturore, një traditë popullore. Dhe ky ndryshim i gjendjes, prej kanunit total, rregullator i përgjithshëm i jetës dhe vdekjes, tek kanuni vepër madhështore kulture e tradite, mund të ishte një faktor lehtësues për të trajtuar temën e tij<sup>46</sup>.

*I foli për kotninë e jetës dhe për njëmendësinë e vdekjes në Veri, për njeriun verior, që vlerësohet apo zhvlerësohet kryesisht nga varësia që krijon me vdekjen dhe për urimin e tmerrshëm që bëjnë malësorët kur lind një foshnjë: “me jetë të gjatë e ta vraftë pushka”, gjë që tregonte se vdekja e natyrshme prej sëmundjeve apo pleqërisë ishte e padenjë për njeriun e bjeshkës. Së fundi, përsëriti mendimin se malësori nuk ka qëllim tjetër, veçse të grumbullojë aq nder në jetë, saqë t'i mjaftojë si kapital për t'i ngritur një monument pas vdekjes*<sup>47</sup>.

---

<sup>43</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 90.

<sup>44</sup> Demush Shala, *Gjurmime albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Folklor dhe Etnologji, IV- 1974, Prishtinë, 1976, f. 91.

Shih: Ndue Dedaj, vep e cit, f. 59. Shih: Koliqi, *Vepra 4*, Faik Konica, Prishtinë 2003, “*Kanûni* ose Kodi i Maleve shqiptare, thuejse i panjohun përjashta, ruen në vetvedi rregulla juridike shumë të lashta që i shkrojnë për shtat bindshëm rregu-llimit të jetës së një shoqnie heroike patriarkore. Gjuha lapidare me të cilën ligjë-bâsi anonim leçitë rregullat themelore të *Kanûnit*, kumbon tashmâ plot frymzime epike. Ka kohë që këto ligje të parahershme s’janë mâ në fuqí, por fryma që i për-shkon ka mbetë në mendsinë e popullit”, f. 13-14.

<sup>46</sup> Shaban Sinani, “Kanuni total” te Prilli i thyer, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009, f.122.

<sup>47</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, vep. e cit., f. 89.

Sikurse pohohej në studimet antropologjike kulturore, vlerat e kulturës tradicionale e humbin fuqinë e brendshme të veprimit në çastin që kalojnë prej oralitetit në literalitet<sup>48</sup>. Në mënyrën e shqyrtimit të traditës etno-juridike vazhdoi të shpërfilllej një prej ligjeve themelore të shkencës së antropologjisë: fuqia e traditave gojore pushon së vepruari pasi ato tejshkruhen, shfaqen si ligjërime të shkruara<sup>49</sup>. Pra thënë ndryshe:

*Atje në Tiranë ka keqkuptime lidhur me kanunin, - tha, me një zë kinse të përmbajtur, madje të lodhur. Ti e di se keqkuptimi nis që me fjalën “kanun”, që shumë njerëz, për shkak të tingëllimit e dinë orientale, domethënë, turke, rrjedhimisht të prapambetur. Dhe, kur ua shpjegon se s’është veçse fjala e vjetër “canon” e te shqiptarët “kanu”, për ta shndërruar më pas, nuk e di pse, në “kanun”, zgurdullojnë sytë. Pas kësaj, meqenëse e humbin rastin për ta cilësuar si turkoshak, nisin ta gjykojnë: a është i mirë, a është i keq, krejt siç pyesin për gjërat kalamajtë. Si çdo e madhërishtë, kanuni është përtej mirësisë ose ligësisë. Ai është përtej<sup>50</sup>.*

Madje studiuesi Sabri Hamiti shton ndër të tjera se: Tri monumente të kulturës shqipe, që mund t’u dhurohen të huajve si shenja identifikimi të kulturës shqipe janë: *Historia e Skënderbeut e Marin Barletit, Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe Kângët kreshnike*.

Këto tri monumentet e mëdha të kulturës shpirtërore të shqiptarëve kanë në emër nga një shenjë diferencuese të gjinisë së shkrimit. Mbasi emri është sendi (gjëja), atëherë emrat: a) Histori, b) Kanun dhe c) Kângë japin esencën e veprave dhe natyrën e tyre strukturore, funksionale e destinuese, kurse përcaktuesit e tjerë japin përkatësinë e veprave në kohë e në hapësirë. Prandaj, historia është e Skënderbeut, Kanuni është i Lekë Dukagjinit, kurse Kângët janë të kreshnikëve.

Besian Vorpsi personazhi kryesor i romanit “*Prilli i thyer*”, i deklaroi së shoqes bindjen se Kanuni s’është vetëm kushtetutë... ai është një mit kolosal në formë kushtetute. Çabej do të ishte i pari që do ta shihte “Kanunin e Lekë Dukagjinit” jo si një kushtetutë etno-juridike në veprim, por thjesht si një vepër kulturore-letrare, duke e përfshirë si të tillë në librin “elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe 1936”.

<sup>48</sup>Shaban Sinani, *Kanuni total, te “Prilli i thyer”*, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009, f.122.

<sup>49</sup>Shaban Sinani, *Etnos në epos*, Naimi, Tiranë, 2011, f. 147.

<sup>50</sup>Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 92.

*Një kushtetutë e vërtetë e vdekjes, tha ai, duke u kthyer befasisht nga ajo. Për të flasin shumë dhe gjithfarë gjërash, megjithatë, sado i egër dhe i pamëshirshëm të jetë ai, për një gjë jam i bindur: kjo është një nga kushtetutat më monumentale të lindura mbi fytyrë të rruzullit tokësor dhe ne, shqiptarët, duhet të jemi krenarë që e pollëm atë<sup>51</sup>.*

Njerëzit mendojnë me paragrafë kanuni, përshendesin me paragrafë kanuni, luten me paragrafë kanuni, vrasin me paragrafë kanuni. Ky fakt konkretizohet qartazi në roman si në rastin:

*Ndonëse ishte prita e dytë për gjakmarrje në jetën e tij, njeriu që duhej të vriste ishte po ai i pritës së parë, kështu që edhe kjo pritë ngjante si vazhdim i saj<sup>52</sup>.*

Kanuni është më i fuqishëm seç thuhet. Gjorgu është ilustrimi i kësaj të vërtete<sup>53</sup>.

*Gjorgu, ashtu siç e kërkonte zakoni, i foli njeriut që po vinte. As në atë çast, as më vonë ai nuk e kuptoi nëse i foli me zë apo zëri nuk i doli. E vërteta ishte që viktima ktheu kryet befasisht. Gjorgu kapi veç një lëvizje të shkurtër të krahut, që, siç dukej, deshi të hiqte nga supi pushkën dhe në atë çast shtiu<sup>54</sup>.*

Dekodifikimi i kodit tradicional të shqiptarëve në veprën e Kadaresë shprehet në dy forma: e para, përmes rënies së ngadaltë, por të pakthyeshme të shkrimtarit Besian Vorpsi, që e sheh realitetin e kanunit total si një dukuri madhështore.

*Besian Vorpsi buzëqeshi hidhur:*

*- Një bari, fqinj me bariun e grigjës, i dëgjoi fjalët e fundit të viktimitës dhe i tha fqinjit të vet. Dhe u ngrit ky i fundit, që as e njihte, as e kishte parë dhe as e kishte dëgjuar kurrë emrin e të vrrarit, u ngrit pra ky bari, la luftën, familjen e çdo punë tjetër, e duke shkuar të marrë gjakun e njeriut të panjohur që iu pre mik në besë të tij, u fut në qerthullin e gjakmarrjes<sup>55</sup>.*

Tek kjo vepër pesha e Kanunit është totalitare dhe kjo vërehet shumë, edhe këtu kemi të paraqitur një prerje në besë, por jo me dëshirën e personit, që ai u dorëzua si mik. Një udhëtar që ishte ne gjak e prej kohësh ruhej nga gjakmarrësit, u ndodh në mesin e një tufe dhish, por që nuk

<sup>51</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 90.

<sup>52</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 24.

<sup>53</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, parathënie, f. 6.

<sup>54</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 25.

<sup>55</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 74.

kishin bari, ai nga frika apo te paktën të mos vritej pa një shenjë thirri bariun e tufës, por ai nuk dëgjoji dhe në fund ai thirri cjapin e këmborës, duke i thënë që t’i tregojë të zotit se nëse ai vritet afër atëherë është mik i prerë në besë dhe sikur e ndjeu këtë pak pasi u largua nga tufa u vra. Kështu i zoti u tufës me dhi ra në gropen e gjakmarrjes.

*Besa e madhe u dha prej Kryeqyqëve mbasdite vonë, pak kohë përpara se të mbaronte afati i së voglës. Një nga pleqtë e katundit, që kishte qenë te Kryeqyqët, erdhi në kullën e Berishajve dhe njoftoi për dhënien e saj, duke përsëritur me këtë rast këshillat e nevojshme se si Gjorku nuk duhej ta shpërdoronte atë etj, etj<sup>56</sup>.*

E dyta, përmes mbërritjes tek e fshehta e tmerrshme, ndoshta kumti më i frikshëm dhe më i kriptuar i gjithë kanunit: thelbi i tij është fitimi, gjakmarrja është një industri, shkolla dhe dituria ka vënë në funksion të kësaj industrie mjeshtëritë më të reja mjekun dhe gjeometrin. Jo nderi fisnik dhe virtyti i lartë, por taksa e gjakut dhe kalendari i llahtarshëm i ulje ngritjeve të lavdisë së “kullës së princit” përbën thelbin e kanunit.

*-Ja një kullë ngujimi,- tha Besiani, duke i rënë dritares me gisht.*

*Diana vështroi andej.*

*-Ajo e veçuara, e shikon? Ajo me frëngji tepër të ngushta.*

*-Sa e zymtë,- tha Diana.*

*Ajo kishte dëgjuar shpesh të flitej për kullat e famshme ku mbylleshin pas mbarimit të afatit të besës gjithë gjakësit që iknin nga shtëpitë për të mos rrezikuar familjet. Ishte hera e parë që shikonte një kullë ngujimi e që dëgjonte hollësi të plota për të<sup>57</sup>.*

Kullat e ngujimit shërbenin që gjakësit të mbylleshin pas mbarimit të besës. Zakonisht në këto kulla njerëzit rrinin me vite të tëra deri sa jashtë të ndodhte ndonjë gjë e ata të arrinin te delnin.

Ligjit të malësisë qi është i ashpër sikurse vargjet e malevet shqiptare, i rreptë si jeta e malësorvet, i tmerrshëm në ndëshkimet e i frymëzuar nga parimi “*gjaku lahet me gjak*”, përmbledhje e

---

<sup>56</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 20.

<sup>57</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 108.

rrjeshtueme rregullash të përdoruna qi kanë zanë vend gjatë shekujvet nëpër fiset malësore, të cilët jetojshin të ndamë nga bota, i a kanë zanë vendin tashma ligjëtar e Shtetit Shqiptar<sup>58</sup>.

*Ai zbriti pas pak me një qese në dorë. Ajo ishte fare e vogël në krahasim me qesen e taksës së gjakut. I ati ia zgjati.*

*- Nisu, Gjorg. Të qoftë udha mbarë!*

*Gjorgu e mori qesen.*

*-Faleminderit, babë.*

*I ati nuk ia hiqte sytë.*

*- Veç mos harro,- i tha me zë të ulët,- besa për ty mbaron më shtatëmbëdhjetë prill.*

*Dukej sikur diçka mungonte brenda gojës së tij.*

*-Mos harro, bir- përsëriti<sup>59</sup>.*

Gjorgu pasi paguan taksen e gjakut në kullën e Oroshit kthehet në shtëpi dhe vendos që ditët e mbetura t'i kaloj duke e shëtitur bjeshkën. I tregon babait të tij dhe ai nuk e kundërshtoj, por i solli të atit një qese me para dhe i uroj udhë të mbarë, por vazhdimisht duke ia kujtuar që besa i mbaronte me shtatëmbëdhjetë prill.

Romani denoncon kanunin, totalitetin e tij, pushtetin e vdekjes, absurdin e jetës, tmerrin e ditës dhe të vitit. Bashkë me këtë denoncohen edhe realitetet paralele, ndër të tjera, siç është edhe totaliteti i kohës kur autori shkroi veprën e tij.

Si letërsi etnografike, pasqyrë e madhësisë së jetës dhe vdekjes kanunore ekzotike shqiptare, do te lexohej edhe nga shumica e studiuesve dhe kritikëve të Perëndimit.

Kanuni, gjakmarrja, kushtëzimi i jetës me vdekjen, në “*Prillin e thyer*”, janë thjesht një pikënisje për të mbërritur në ide ekzistencialiste, të cilat autori i fsheh mjeshtërisht pas traditës. Në romamin “*Prilli i thyer*” njerëzit janë të pafuqishëm deri në robëri për të kundërshtuar një sistem rregullash të vrazhda. Ata nuk janë zotër të jetës së vet. Pesha e kanunit është totalitare. Rendi shoqëror e kthen njeriun në një qenie pa jetë. Karakteret janë robër të fatit të tyre dhe të një rendi absurd rregullash çnjerëzore. Shumica e veprimeve të personazheve janë pa kuptim në rendin e

---

<sup>58</sup>Po aty, f. 9.

<sup>59</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 148.



logjikës normale. Gjorgu vret dhe nuk e di pse vret; ai qëllon hasmin, për të cilin i vjen keq; dhe askush nuk mund të thotë nëse merr hak Gjorgu apo merr hak një sistem shoqëror.

Për të zbuluar Shqipërinë e hershme evropiane shkrimtari shpesh i është drejtuar fundit të Mesjetës, kohës së Humanizmit evropian. Qëllimi i tij në veprën “*Prilli i thyer*” nuk është ta hyjnizojë Kanunin, por ta deshifrojë atë, ta dekodifikojë; dhe të marrë shkas për të ndërtuar paralele me kohën që jetonte<sup>60</sup>.

Jeta e njeriut nën Kanun është jeta e një individi të robëruar prej tona-litetit të nyjave të tij. Po aq total dhe mbikëqyrës sa kanuni në vitet 1930 është ideologjia sunduese e kohës në vitet 1970-1980. Njeriu i kanunit nuk është njeriu i virtytit dhe i nderit kalorësiak, siç është paraqitur në disa studime, por një qenie fatale që nuk ka asgjë në dorë. Ai duhet të arsyetohet me Kanun, duhet të përshëndesë me Kanun, të zërë vend në odë e në bujtinë siç e parasheh Kanuni, të burrërohet me Kanun, të vrasë me Kanun. Kanuni është ndërgjegje e nëndërgjegje, është ideologji dhe moral, është pushtet dhe bindje, është rend dhe fuqi<sup>61</sup>.

### 2.3 Besa kanunore dhe tradita shqiptare në roman

Ismail Kadare, tek tregon për përdorimin e titujve të veprave të tij në formë të shkurtuar, me nofka a me emra përmbledhës, kështu romani *Prilli i thyer* ishte thjesht romani i Veriut<sup>62</sup>.

*Shkrimtari Besian Vorpsi me gruan e tij të re, Dianën, vendosën ta bëjnë muajin e mjalit në Rrafshin e Veriut.*

Arti letrar, si dhe gjithë artet e tjera, i ofrojnë lexuesit njohuri si dhe interpretim të strukturave domethënëse, çka i shtyn ta gjykojmë kritikun në marrëdhënie të ndërsjellë midis veprës dhe dukurisë historike, të cilën e konsiderojnë një faktor të zhvillimit artistik<sup>63</sup>.

---

<sup>60</sup>Shaban Sinani, *Kanuni total te Prilli i thyer*, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009, f. 145.

<sup>61</sup>Po aty, f. 145.

<sup>62</sup>Krisanthi Feçani, *Veçori të kronotoposit në veprën “Prilli i thyer” të Ismail Kadaresë dhe “Mali magjik” të Tomas Manit*, në: “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, nr. 1-2, Tiranë, 2004, f. 33.

<sup>63</sup>Floresha Dado, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2009, f. 30-31.

Rëndësia dhe përmasa e vërtetë e rolit emancipues dhe reformator të veprës së Kadaresë në kulturën shqiptare bëhet më i qartë po të kemi parasysh faktin se zhvillimin letrar në Shqipërinë e kohës e mundonin kufizimet e imponuara prej kontekstit politik-ideologjik, prej një modeli kulturor komod për orientimin zyrtar të jetës artistike dhe shpirtërore të asaj shoqërie e pa dyshim edhe forca e inercisë së traditave artistike anakronike<sup>64</sup>.

Në kohën që Kadare shkroi romanin e tij “*Prilli i thyer*”, kanuni ishte shkurorëzuar nga fuqia etnozakonore dhe ishte thjesht një traditë. Nuk ishte një realitet parësor, si në vitet 1930, por një përmendore kulturore, një traditë popullore.

*-Gjorg Berisha vrau Zef Kryeqyqen, e morët vesh?*

*- Gjorgu i Berishajve lau gjakun e të vëllait.*

*-A do ta kërkojnë Berishajt besën njëzetekatërorëshe.*

*-Me siguri, po<sup>65</sup>.*

Këtu kemi të paraqitur personazhin kryesor të veprës Gjorgun i cili ishte trashëgimtari i vetëm i familjes Berisha të cilët janë në gjak me familjen e Kryeqyqeve dhe pasi Kryeqyqet i kishin vrarë Gjorgut vëllain ai mori amën në krah dhe niset të marr gjakun e vëllaut dhe vret një nga familjaret e tyre Zefin.

Elementet bazë kanunorë si: *gjaku, miku dhe besa*, shtejllohen nga shkrimtari Besian Vorpsi, shkrimtar, njëkohësisht si përkufizime juridike dhe si përkufizime mitike.

*Ja, katër burra midis tyre një plak, po ecnin drejt shtëpisë se të vrarit.*

*- Ndërmjetësit po shkojnë të kërkojnë besën njëzetekatërorëshe për Berishajt, -thoshte dikush nga një dritare.*

*-Do ta japin vallë?*

*- Besa , po.*

*Megjithatë gjithë fisi i Berishajve po merrte masat e mbrojtjes. Aty-këtu dëgjoheshin zëra:*

*Murrash, eja shpejt në shtëpi. Cen, vuri shulin portës. Ku është Prenga?<sup>66</sup>.*

---

<sup>64</sup> Jorgo Bulo, *Kadareja dhe letërsia shqipe*, në: “Studime Filologjike”, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2006, f. 5.

<sup>65</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 15.

<sup>66</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 15.

Sipas ligjeve kanunore mbi të cilat është e ndërtuar vepra pas vrasjes kërkohet besa njëzetekatërorëshe për vrasësin. Këtu kemi te paraqitur shkuarjen e disa njerëzve tek familja e Kryeqyqeve për kërkim të besës për Gjorgun, por familja Berisha pavarësisht kësaj ata prapë filluan të merrnin masa mbrojtëse, se në qoftë se nuk jepnin besën ata duhet të jenë të përgaditur.

*Familja e Kryeqyqëve e çeli besën.*

*Të gjithë e kuptonin se ishte fjala për besën e vogël, njëzetekatërorëshe. Kurse besën e madhe, tridhjetëditëshen, atë që mund t'ua lypte Kryeqyqëve veç katundi, fill pas varrimit, s'e përmendte kush.*

*Zërat fluturonin nga pingu në ping.*

*-Familja e Kryeqyqëve e çeli besën.*

*- E çelën besën Kryeqyqët.*

*-Lavdi Zotit! Së paku njëzet e katër orë s'ka për t'u derdhur më gjak,- psherëtiu një zë i ngjirur pas një flegre<sup>67</sup>.*

Për njëzetekatërorë familja e Kryeqyqeve e çeli besën që d.m.th për njëzetekatërorë këto dy familje, që janë në konflikt konkretisht për familjen Berisha nuk ka rrezik që mund të ndodhë ndonjë vrasje.

Dhe vijonin fjalët për zanat e shtojzovallet, për rapsodët, homerikët e fundit të botës, dhe për kanunin e tmerrshëm, por madhështor si asnjë tjetër<sup>68</sup>.

*Vijat e tirqve të tyre ishin fare pranë vijave të tirqve të tij, gjarpërinj të zinj me kokat plot helm, që ishin gati të kafshoheshin. Në ecje e sipër ato gati sa nuk prekeshin. Por ai ishte krejtësisht i qetë. Ishte i mbrojtur nga besa njëzetekatërorëshe më mirë se nga çdo frëngji kulle apo keshjtelle<sup>69</sup>.*

Pas vrasjes sipas kanunin dorërasit duhej të shkonte në cermoninë e varrimit, sepse po nuk shkoi atëherë ai nuk llogaritej si burrë. Dhe Gjorgu e tregoj që është vërtet një burrë, duke shkuar në cermoni dhe ashtu siç e donte zakoni i ulur në mes të familjes, që ai ua kishte vlarë njërin nga ta, por nuk kishte frikë, sepse ai ishte i mbrojtur mirë nga besa njëzetekatërorëshe.

<sup>67</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 16.

<sup>68</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 81.

<sup>69</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 17

*Mbasdite, pas drekës së mortit, në katund nisën prapë ecejaket e pazakonshme. Pas dita orësh mbaronte besa e vogël njëzetekatërorëshe për Gjorg Berishën dhe qysh tani pleqnarët e katundit po bëheshin gati të paraqiteshin të kulla e Kryeqyqëve, për të kërkuar për Gjorgun, në emër të fshatit, besën e madhe, tridhjetëditëshen<sup>70</sup>.*

Pas mbarimit të besës së vogël apo besës së shkurtër atëherë kërkohet besa e madhe tridhjetëditëshe nga më të vjetërit e fshatit, që d.m.th kjo besë kërkohet nga i gjithë fshati për dorasësin, që në këtë rast është Gjorgu.

*Besa e madhe u dha prej Kryeqyqëve mbasdite vonë, pak kohë përpara se të mbaronte afati i së voglës. Një nga pleqtë e katundit, që kishte qenë të Kryeqyqët, erdhi në kullën e Berishajve dhe njoftoi për dhënien e saj, duke përsëritur me këtë rast këshillat e nevojshme se si Gjorgu nuk duhej ta shpërdoronte atë etj..etj<sup>71</sup>.*

Zakonisht pasi që jepej besa e vogël kërkohet edhe besa e madhe tridhjetëditëshe por që edhe kjo në shumicën e rasteve jepej, sepse kërkohet nga i gjithë fshati, dhe kjo besë u dha edhe për Gjorgun.

*Kishte vetëm gjysmë orë që kishte dhënë besa tridhjetëditëshe, dhe ai gati po mësohej me mendimin se jeta e tij ishte e ndarë perfundimisht në dy copa. Madje tani i dukej se ajo kishte qenë gjithmonë kështu: njëra copë e gjatë, njëzet e gjashtë vjet, një jetë e ngadaltë, e ngadaltë gjer në mërzi, njëzet e gjashtë marse e prille e po aq dimra e vera, kurse copa tjetër, vetëm me një gjysmë mars e gjysmë prill, si dy gjysma dege të thyera plot rrezëllimë bryme. Ç’do të bënte në këto tridhjetë ditë që i mbeteshin?*

*Zakonisht në kohën e besës së madhe njerëzit shpejtonin të kryenin atë që s’kishin kryer dot gjatë pjesës tjetër të jetës. Dhe në qoftë se s’u kishte mbetur ndonjë gjë e madhe për të bërë, atëherë shpejtonin të kryenin punët e përditshme<sup>72</sup>.*

Gjorgu një djalë i ri vetëm njëzet e gjashtë vjet pasi mori besën e madhe tridhjetëditëshe filloi të mësohet me mendimin, që ai është një i vdekur që merr frymë, që ka vetëm disa ditë leje për të jetuar dhe se jeta e tij ishte e ndarë në dy pjesë: njëra pjesë që kishte njëzet e gjashtë dimra e vera

<sup>70</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 17.

<sup>71</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 20.

<sup>72</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 21.

dhe pjesa tjetër, që kishte gjysmë marsin e gjysmë prillin. Zakonisht gjatë kohës që njerëzit ishin në besë ata kryenin punët, që u kishin mbetur në gjysmë ose kryenin të mbjellurat apo të korrurat varësisht në çfarë periudhe kohore i zinte besa.

*Copa të veçanta të këtyre rrugëve ishin në besë të përhershme. Kështu, në Rrugën e Madhe të Flamurëve, pjesa nga Ura e Gurtë e gjer te Gështenjat e Mëdha ishin në besë të Nikajve e të Shalës. Kushdo që pësonte gjë duke ecur nëpër to, gjaku i mbetej krahinës së Nikajve dhe Shalës. Po kështu, në Rrugën e Hijes pjesa nga Arat e Rekës gjer te Kroi i Ftohtë ishin në besë. Konakët e Nikajve e të Shalës ishin gjithashtu në besë. Hani i Vjetër, në Rrugën e Kryqit, me përjashtim të stallës, ishin në besë. Bujtina e Vejushës, gjithashtu, bashkë me katërqind hapa udhë nga porta veriore<sup>73</sup>.*

Përveç kullave të ngujimit për gjakësit egzistonin edhe rrugët në besë nëpër të cilat ata mund të ecnin të lirë pa pasur frikën se mund t'i vrisnin, por të cilat ishin të kufizuara. Këtu kemi të paraqitur rrugë të cilat janë në besë të familjes Shala e Nikajve.

Në këtë roman vajtje-ardhjet letrare kryhen pikërisht nëpërmjet skemash mitizuese ose mitologjike. Besian Vorpsi e interpreton përkufizimin e Mikut në Kanun kështu: Miku për shqiptarin është gjysmë perëndi, ndërsa shumë popuj i kanë rezervuar malet për hyjnitë malësorët tanë, duke qenë se i kanë ato të vetmet troje banimi, kanë qenë të detyruar që ose t'i dëbojnë hyjnitë që andej, ose t'i përshtatin sipas vetes, në mënyrë që të mund të jetojnë të përzier me ta. Kështu shpjegohet kjo botë gjysmë reale, gjysmë fantastike në Rrafsh si në kohërat homerike.

*Gjorgut iu kujtua se si vite më parë në katundin e tij ishte ndërshkuar një prerje në besë. Vrasësi ishte grirë katundisht, duke shkuar gjakhupës. Shtëpia ku miku ishte prerë, pavarësisht se njerëzit e saj nuk ishin fajtorë, u dogj. Vetë i zoti i saj printe me urë e sëpatë, duke klithur sipas zakonit: “I marrsha të ligat katundit dhe flamurit”. Pas tij, me urë e me sëpata në duar, vinte gjithë fshati. Pas kësaj, të zotit të shtëpisë, për vite me rradhë gjithçka duhej t'i jepej me dorë të majtë e për nën gju, për t'i kujtuar se duhej të hakmerre mikun. Sepse dihej që baba, vëllai, madje edhe fëmija i vrarë mund të faleshin, por miku i prerë, kurrë<sup>74</sup>.*

<sup>73</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 148.

<sup>74</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 41.

Tradita e mikpritjes është një nga shenjat identifikuese të virtytetve të shqiptarëve dhe miku kur vjen në shtëpi për shqipëtarët konsiderohet si perëndi dhe prerja e tij në besë është për shqipëtarët gjëmë shumë e madhe. Nëse miku prehet në besë atëherë për atë familje kishte denime nga me të këqijat, që në këtë rast kemi djegien e shtëpisë pastaj si dënim për të zotin e shtëpisë për vite me rradhë çdo gjë i jepej nën gju dhe me dorën e majtë.

*Ishte fare i vetëm nën qiellin që tani dukej sikur që anuar pakëz nga perëndimi prej peshës së diellit. Rreth e rrotull dita ishte po ajo, po ai ajër dhe po ai ndriçim i purpurt, megjithatë koha e besës kishte mbaruar dhe tani ai kishte hyrë në kohën tjetër. Më sy të ngrirë vështronte përreth. Ja pra, kjo ishte koha përtej besës. Koha sipërane që s'i përkiste më atij, pa ditë, stinë, vite e të ardhme, një kohë e përgjithshme. Me të cilën ai s'kishte asnjë punë<sup>75</sup>.*

Pasi Gjorgut i mbaron besa ai shikon rreth e rrotull dhe sheh që është e njëjta ditë dhe i njëjti ajër, por që më nuk i përkasin atij, sepse ai vet nuk i përket më të zakonshmes jetë.

Personazhet e romanit, me përjashtim të atij femëror, Dianës së bukur qytetase, e dinë ato përmendësh dhe i kanë më se të qarta si në përmbajtje ashtu edhe në interpretim. I vetmi personazh, tek i cili lind përfytyra mitike e kësaj ligjësie të përsosur është shkrintari dhe intelektuali qytetas, Besian Vorpsi.

Njohës i mirë, por i papërfshirë në këtë rregullator të jetës malësore, ai e vështron atë së jashtmi. Nga ky qëndrim prej spektatori dhe nga përzierja mitiko-letrare në vështrimin e tij, qarkullon në roman edhe një shenjim i intertekstit mitik në nivel të dytë<sup>76</sup>.

Besian Vorpsi është spektatori-udhëtar nëpër Rrafshin verior shqiptar, ai është ndërgjegjia e jashtme, është Tjetri, që shfaqet në një botë të lartësuar në kufijtë e tragjedisë dhe të mitit, të cilën ai vetë me adhurim dhe tmerr e quan “zona e vdekjes”. Por pavarësisht nga perceptimi i këtij udhëtimi si përgjatë një skene ku luhet një tragjedi antike, ai nuk mundet dhe është i paafte të jetë spektatori i vërtetë i tragjedisë që sodit.

*-Ajo do të jetë vallë kulla e ngujimit?- pyeti Diana.*

*- Ndoshta. Ashtu me duket.*

---

<sup>75</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 192.

<sup>76</sup> Persida Asllani, *Kanuni në prozën shqipe: miti i përbashkët i shenjtërimit*, në: Studime Filologjike, nr. 1-2, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2008, f. 38-39.

*Diana mbajti këmbët për ta parë me mirë përgun e mënjauar.*

*-Në qoftë se atij malësorit që pamë atëherë, atij që biseduam sot, i ka mbaruar besa këto ditë, me siguri ka përfunduar në ndonjë të tillë, apo jo?- pyeti Diana*

*-Sigurisht,- u përgjigj Besiani, pa i hequr sytë nga grumbulli i njerëzve.*

*-E, në qoftë se mbarimi i besës e zë gjakësin në udhëtim e sipër, larg katundit të vet, atëherë ai mund të futet në çfarëdo kulle ngujimi?*

*-Besoj se po. Është e njëjta gjë si për udhëtarët që i zë nata dikun dhe futen në bujtinën e parë që u del përpara<sup>77</sup>.*

Diana dhe Besiani gjatë udhëtimit të tyre hasen edhe në kulla të ngujimit. Diana kur e pa së pari Gjorgun nga karroca disi ndjeu diçka thellë në zemër dhe gjatë gjithë kohës, pra gjatë udhëtimit të saj në rrafsh, ajo mendonte për Gjorgun të cilit i pau edhe shiritin e zi në krahë. Ndaj kuptoj se ai ishte një njeri që kishte vlarë dikë dhe pritej që edhe ai vetë të vritej. Ky fakt e shtyu të mendonte edhe për mbarimin e besës se tij dhe kur pa një kullë ngujimi i shkoi menjëherë tek Gjorgu, ku e pyeti të shoqin e saj se mos vallë ka mundësi që edhe ai të ketë përfunduar në një nga ato kulla të shumta, dhe Besiani pasi që kishte njohuri lidhur me kanunin, ligjet dhe besën, natyrisht i tregojë Dianes për çdo mundësi, që mund t'i ketë ngjarë Gjorgut dhe ai të jetë futur në kullë ngujimi.

Besian Vorpsi është njohës i mirë, por një spektator pasiv. Ai nuk ka kurrfarë zëri që e përcjell në brendësi të tragjedisë. Asgjë nuk luhet dhe nuk vepron për të.

*Ai ngriti kryet lart për të kërkuar në qiell diellin, të cilin retë e larta e mbulonin pa e fshehur megjithatë vendin ku ndodhej. Mesdita nuk është larg, mendoj, duke e ulur vështrimin mbi udhë. Nga Ibyrja e syve udha i dukej plotë pasqyrime të kuqërremta. Tek ecte, mendonte se, në qoftë se besa e tij do të mbaronte në mbrëmje, ai do të kish mundur të mbërrinte në shtëpi së paku aty nga mesnata. Mirëpo ajo, si shumica e besëve, mbaronte në mesditë. Dihej se në këtë rast, në qoftë se i besëtuari vritej pikërisht ditën e mbarimit të besës, i shikohej se në ç'anë i bënte hije koka fill pas rrëzimit në tokë, nga perëndimi apo nga lindja. Në qoftë se hija binte nga lindja, do*

---

<sup>77</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 172.

*të thoshte se ai ishte vrarë pas mesditës, pra pas mbarimit të besës. Në qoftë se koka i bënte hije nga perëndimi, do të thoshte se ishte vrarë para kohe, pra me pabesi*<sup>78</sup>.

Pasi ishte mbaruar besa tridhjetëditëshe, pra besa e madhe Gjorgu u detyrua të kthehej në shtëpi, për t'i takuar edhe njëherë për herë të fundit familjarët e tij.

Rrugës duke u kthyer shikonte diellin dhe e kuptoj, që besa e tij kishte përfunduar, sepse kur jepej besa tridhjetëditëshe ajo përfundonte në mesditë dhe sipas kanunin kur i besëtuari vritet menjëherë pas mbarimit të besës atëherë, duhet shikuar se nga cila anë i bënte hije koka dhe nëse hija ishte nga lindja atëherë ai është vrarë pasi që i ka mbaruar besa, por nëse bënte hija nga perëndimi atëherë ai është vrarë me pabesi.

I përjashtuar nga ligjësitë që e rrethojnë, ai është i përjashtuar nga komunikimi njerëzor me këtë botë, është i përjashtuar nga spektakli që po kundron. E vetmja pikë takimi e vërtetë dhe konkrete me botën spektakolare të maleve është bashkëshortja e tij, Diana.

*-Dianë,-i tha me zë të ulët,- shiko përjashta. Me duket se kjo është një rrugë në besë. Ajo afrroi kryet të shihte. Gjithmonë me zë të ulët, me fjalë të kursyera, që i lidhte në një mënyrë përherë e më të panatyrshme, ai shpjegoi se ç'ishte një rrugë në besë. I dukej se drita e akullt e hënës e ndihmonte*<sup>79</sup>.

Ndërkohë ajo, e bukura qytetase është përceptuar si një zanë mali nga ana e malësorëve për shkak të bukurisë dhe largësisë së saj. Për arsye të ndryshme, Besiani dhe Gjorgu, drejt fundit të romanit e quajnë atë zanë. Njëri e humbet, tjetri Gjorgu humbet jetën prej saj.

Në roman hasim edhe përqasjen e dy sistemeve juridike në nivel kombëtar. Kanuni rezulton i përceptuar nga shqiptarët nën diktaturën komuniste si vlerë etike, si matricë e një lloj demokracie të lashtë e të humbur.

---

<sup>78</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 187.

<sup>79</sup> Ismail Kadare, *Prilli i thyer*, f. 157.



## PËRFUNDIME

Ismail Kadare protagonist i jetës kulturore dhe letrare në Shqipëri për më se gjysmë shekulli krijoi një vepër të madhe dhe të papërsëritshme, dhe i dha një përmasë të re letërsisë shqipe duke e imponuar atë si fakt dhe si faktor edhe të procesit letrar botëror. Personaliteti dhe vepra e Kadaresë kanë luajtur rolin e një shkolle në zhvillimin dhe ripërtëritjen e letërsisë shqipe; vepra e tij ka ushtruar një ndikim aq të madh dhe kanë pasur një forcë aq të madhe tërheqëse saqë, pa to, nuk mund të kuptohet gjithë procesi i risimit dhe i emancipimit të kulturës shqiptare në rrjedhë të kohëve moderne të saj.

Proza e Ismail Kadaresë është një prozë sa origjinale dhe e mbushur me plot emocion. Ai shkruan dhe rrëfen në radhë të parë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Krijimtaria e tij është e lidhur me truallin shqiptar, me mitet, legjendat, doket, zakonet, vetëdijen dhe kulturën shqiptare. Romani *Prilli i thyer* që në ngjizje të tij ka tharmin shqiptar, ka një dukuri tipike shqiptare siç është ajo e gjakmarrjes. Në roman jepet gjatë e gjerë mënyra sesi veprohet kur merret një gjak, që në çdo rast një gjak duhet të merret patjetër, asnjë fis nuk duhet të shkojë gjakhupës.

Gjatë analizës së kësaj teme na doli në pah evidentimi i besës në letërsi dhe në folklor të para përmes dy romaneve të Ismail Kadaresë, siç janë romani *Kush e solli Doruntinen* dhe *Prilli i thyer*.

Duke qenë se Ismail Kadare me sjelljen e këtyre dy veprave të tij në botën dhe kritikën shqiptare, solli edhe të kalurën dhe të sotmen në përballje të herë pas hershme me njëra-tjetrën nga njëra anë, por nga ana tjetër edhe një pjesë të traditave dhe kulturës shqiptare, si dhe për të realizuar këtë punim na u nevoiten metoda biografike e autorit, metoda sociologjike dhe metoda e krahasimit.

Në romanin *Kush e solli Doruntinen* autori ka synuar të pohojë tiparet e larta të karakterit të shqiptarit, që janë pjesë përbërëse e vitalitetit të popullit tonë. Këto tipare do t'i pohojë përmes figurës së Kostandinit, i cili në novelë jepet përmes retrospektivës, ndonëse jepet si i vdekur para fillimit të ngjarjeve, përmes figurave të shokëve të tij dhe mandej figurës së Stresit, kur ai pranon idealet e tyre dhe pranimi i këtyre mendimeve shihet si një kthesë, një fitore morale në jetën e personazhit, t'i flasë hapur popullit dhe të japë dorëheqjen.

Në romanin *Kush e solli Doruntinën* çështja qendrore që rrihet nga të katër anët është të gjendet një njeri që e solli Doruntinën. Sipas baladës popullore është Kostandini që ngrihet nga varri dhe shkon e sjell motrën, për ta çuar në vendin e premtuar që i patë dhënë kur ishte gjallë nënës së tij. Duke u nisur nga legjenda e Kostandinit me Doruntinën, njëra nga më të lashtat e epikës sonë legjendare, që në motërzimet e veta haset dhe në popuj të tjerë, legjendë që është ngritur mbi motivin e besës, autori zberthen një varg idesh e situatash mbi motivin e besës, autori zberthen një varg idesh e situatash që flasin për kohën, për problemet shoqërore, ekonomike e patriotike, duke i parë e interpretuar ato me frymën tonë të shkrimtarit të realizimit socialist, nga pozitat tona marerialiste. Në përshtatje me materialin brendësor dhe thurjen artistike që ofron vetë legjenda tek kjo baladë, autori ka gjetur formën e novels.

Ideja e qëndresës që identifikohet me poetizimin e besës zbulohet në plan moral dhe jo në rrënjët e saj historiko-shoqërore. Kjo ia dobëson disi novelës vlerën aktuale.

Nga ana tjetër vendi tepër i madh që i jepet në novelë së ashtuquajturës enigmë të ardhjes së Doruntinës sikur është në vetvete jo aq funksional dhe ngjan sa ka për qëllim të mbajë gjallë interesin e lexuesit nëpërmjet kureshtjes, më tepër sesa t'i shërbejë idesë, duke e qartësuar atë.

Romani "*Prilli i thyer*" është cilësuar si romani i "kultit shqiptar të nderit", një prej atyre albanizmave që shumë dijetarëve të huaj u ka mjaftuar për të përveçuar botën tradicionale shqiptare, pothuajse në të gjitha gjuhët e huaja titulli i romanit "*Prilli i thyer*" nuk e ruan titullin dhe kuptimin e dhënë nga autori.

Leximi si "letërsi tradite" apo si letërsi etnografie, që është leximi më tradicional i romanit "*Prilli i thyer*", përbën një kufizim për përftimin estetik të vlerave të tij.

Rëndësia dhe përmasa e vërtetë e rolit emancipues dhe reformator të veprës së Kadaresë në kulturën shqiptare bëhet më i qartë po të kemi parasysh faktin se zhvillimin letrar në Shqipërinë e kohës e mundonin kufizimet e imponuara prej kontekstit politik-ideologjik, prej një modeli kulturor komod për orientimin zyrtar të jetës artistike dhe shpirtërore të asaj shoqërie e pa dyshim edhe forca e inercisë së traditave artistike anakronike.

Romani denoncon kanunin, totalitetin e tij, pushtetin e vdekjes, absurdin e jetës, tmerrin e ditës dhe të vitit. Bashkë me këtë denoncohen edhe realitetet paralele, ndër të tjera, siç është edhe totaliteti i kohës kur autori shkroi veprën e tij.

Si letërsi etnografike, pasqyrë e madhështisë së jetës dhe vdekjes kanunore ekzotike shqiptare, do te lexohej edhe nga shumica e stu-diuesve dhe kritikëve të Perëndimit.

Kanuni, gjakmarrja, kushtëzimi i jetës me vdekjen, në *“Prillin e thyer”*, janë thjesht një pikënisje për të mbërritur në ide ekzistencialiste, të cilat autori i fsheh mjeshtërisht pas traditës. Në romamin *“Prilli i thyer”* njerëzit janë të pafuqishëm deri në robëri për të kundërshtuar një sistem rregullash të vrazhda. Ata nuk janë zotër të jetës së vet. Pesha e kanunit është totalitare. Rendi shoqëror e kthen njeriun në një qenie pa jetë. Karakteret janë robër të fatit të tyre dhe të një rendi absurd rregullash çnjerëzore. Shumica e veprimeve të personazheve janë pa kuptim në rendin e logjikës normale. Gjorgu vret dhe nuk e di pse vret; ai qëllon hasmin, për të cilin i vjen keq; dhe askush nuk mund të thotë nëse merr hak Gjorgu apo merr hak një sistem shoqëror.

Për të zbuluar Shqipërinë e hershme evropiane shkrimtari shpesh i është drejtuar fundit të Mesjetës, kohës së Humanizmit evropian. Qëllimi i tij në veprën *“Prilli i thyer”* nuk është ta hyjnizojë Kanunin, por ta deshifrojë atë, ta dekodifikojë; dhe të marrë shkas për të ndërtuar paralele me kohën që jetonte.

## BIBLIOGRAFIA

- Asllani, Persida, *Kanuni në prozën shqipe: miti i përbashkët i shenjtërimit*, në: “Studime Filologjike”, nr. 1-2, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2008.
- Bulo, Jorgo, *Kadareja dhe letërsia shqipe*, në: “Studime Filologjike”, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2006.
- Çaushi, Tefik, *Dashuria dhe Besa (ese për romanin e Kadaresë “Kush e solli Doruntinën)*, Albas, Tiranë, 2004.
- Çaushi, Tefik, *Universi i Kadaresë*, Tiranë, 2001.
- DADO, Floresha, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2009.
- Dervishi, Zyhdi, *Vështrime të kryqëzuara në det*, Sociologjia Kulturore1, “Jerusalem”, Tiranë, 2003.
- Dilaveri, Dilaver, në gazeten: “Zëri i Rinisë, 09.08.1980.
- Dushi, Arbnora, *Elemente të epikës gojore në prozën e Ismail Kadaresë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2004.
- Feçani, Krisanthi, *Veçori të kronotoposit në veprën “Prilli i thyer” të Ismail Kadaresë dhe “Mali magjik” të Tomas Manit*, në: “Studime filologjike”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, nr. 1-2, Tiranë, 2004.
- Fetiu, Sabri, *Çështje të folklorit 5*, Tiranë, 1997.
- Fetiu, Sadri, *Aspektete të studimit të baladës popullore shqiptare*, në: “Gjurmime albanologjike”, Folklor dhe etnologji, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2014.
- Ismail Kadare, *Autobiografia e popullit në vargje*, Onufri, Tiranë, 2002.
- Kadare, Ismail, *Eskili ky humbës i madh*, Onufri, Tiranë, 2001.
- Kadare, Ismail, *Kush e solli Doruntinën*, Onufri, Tiranë, 2004.
- Kadare, Ismail, *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë, 2005.
- Këngë popullore legjendare, Instituti i shkencave, Tiranë, 1955, f. 23.
- Kodra, Klara, revista “Nëntori”, nr.2, Tiranë, 1980.
- Koliqi, Ernest, *Vepra 4*, Faik Konica, Prishtinë, 2003.
- Kuteli, Mitrush, *Tregime të moçme shqiptare*, Mitrush Kuteli, Tiranë, 2005.

Shaban, Sinani, *Kanuni total” te Prilli i thyer*, në: “Studime filologjike”, nr. 1-2, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009.

Shala, Demush, *Gjurmime albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Fol-klor dhe Etnologji, IV- 1974, Prishtinë, 1976.

Sinani, Shaban, *Etnos në epos*, Naimi, Tiranë, 2011.

Sinani, Shaban, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, Tiranë, 2009.

Vata, Rovenca, *Urë fjalësh midis letërsisë dhe antropologjisë*, Enti Botues “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2015.